Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

KAÇANIKU

Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPSTINA KAČANIK

| Data 02.08/19 | Vendi Kaçanik |
|---|---|
| Nj. org. / Numri / Shtojce | 01 Nr. 060/01 - 22628/19 |

**PËR: Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal,**
**-Zyrës Ligjore-**
**NGA: Kryesuesi i Kuvendit të Komunës Kaçanik, Kemal Mërseli**

**Lënda: Dërgimi i Vendimeve të mbledhjes së VII (Shtatë) të Rregullt të Kuvendit të Komunës Kaçanik, mbajtur me 30.07. 2019.**

Bashkëlidhur me këtë Shkresë, u dërgojmë, Vendimet e Kuvendit të Komunës Kaçanik, nga mbledhja e VII (Shtatë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë: 30 Korrik 2019, dhe atë:

1. Vendimi për aprovimin e Planit të Veprimit për Zbatimin e Rekomandimeve të dhënë në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare të Auditimit për PFV 2018 / Lënda: 01Nr. 470/03-21361/19;

2. Vendimi për rialokimin dhe transferin e mjeteve buxhetore sipas buxhetit të vitit 2019 / Lënda: 01Nr. 400/01-22496/19;

3. Vendimi për përzgjedhjen e anëtarëve të Komitetit Konsultativ për persona me aftësi të kufizuara në Komunën e Kaçanikut / Lënda: 01Nr. 60/01-18735; dhe

4. Vendimi për ndryshim plotësimin e vendimit 01Nr.104/02-18863/19- të datës 28.06.2019 –Për formimin e komisionit të ankesave të palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës / Lënda: 01Nr. 104/02-23792/19.

Vendimet ua dërgojmë në afatin e përcaktuar ligjor, me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së tyre nga Zyra Ligjore e MAPL-së.

Me respekt!

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPSTINA KAČANIK
REPUBLIKA KOSOVA

KAÇANIKU

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

**01 Nr. 470/03-21361/19**
**Kaçanik, 30.07.2019**

Në bazë të nenit 12.2(d) të Ligjit- Për Vetëqeverisjen Lokale(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/ 04 Qershor 2008) të nenit 58 të Rregullores për Punë të Kuvendit të Komunës, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur me datë 30 Korrik 2019, mori këtë:

**VENDIM**
**PËR APROVIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE NGA TË GJETURAT E AUDITORIT PËR PVF 2018**

**1.** Me këtë Vendim, Aprovohet Plani i Veprimit 01 Nr. 470/03-21361 -Për zbatimin e Rekomandimeve nga të gjeturat e Auditorit për PVF, 2017, i propozuar nga Kryetari i Komunës prej datës 12.07.2019.

**2.** Në Planin e Veprimit si në pikën 1 të këtij Vendimi, janë paraqitur: veprimet të cilat do t'i merr Kryetari i Komunës dhe zyrtarët tjerë përgjegjës për zbatimin e Rekomandimeve dhe afati kohor për të gjeturat e Auditorit për PVF 2018 dhe i njëjti është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

**3.** Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita e dërgimit të aktit në MAPL respektivisht 7 ditë pas publikimit në Faqen Zyrtare të Komunës.

**4.** Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesën: Kryetari i Komunës dhe zyrtarët tjerë përgjegjës të përcaktuar si në Planin e Veprimit 01 Nr.470/03-21361/19 - Për zbatimin e Rekomandimeve nga të gjeturat e Auditorit për PVF, 2018.

**Me këtë vendim njoftohen:**

1. Kryetari i Komunës/ përmes Zyrës së Kryetarit, njoftohen zyrtarët përgjegjës –zbatues të Planit të Veprimit,
2. Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit dhe
3. Arkivi.

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E KAÇANIKUT OPŠTINA KAČANIK REPUBLIKA KOSOVA

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli

KAÇANIKU

REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAČANIK

| I | Data 12·07·19 | Vendi KAÇANIK |
|---|---|---|
| Nj. org. | Numri | Shtojcë |
| 01 | 470/03-21361 | /. |

**Komuna e Kaçanikut**
**Opština Kacanik**
**Municipal Kacanik**

**Për Zyrën Kombëtare të Auditimit**
**Nga z.Besim Ilazi, Kryetar i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS * KOMUNA E KAÇANIKUT * REPUBLIKA KOSOVA * OPŠTINA KAČANIK

## PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE

**të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit për PFV'2018**

| Nr. | Komponenta e Auditimit (Kapitulli) | Gjetja | Rekomandimi | Veprimet e planifikuara për tu ndërmarrë | Zyrtari/ët përgjegjës | Data e planifikuar e zbatimit të rekomandimit | Komente |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **1** | **Opinioni i Auditimit** | **Çështja C1-Realizimi i buxhetit:** | Kryetari duhet të bëj një vlerësim gjithpërfshirës të shkaqeve të | Të gjitha njësitë organizative do të jenë të angazhuara që planifikimet e | Zyra e Kryetarit ne kordinim të ngushtë me | Janar – Dhjetor 2019 | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes:**<br><br>Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2018 ***paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë*** në të gjitha aspektet materiale.<br><br>Theksimi i çështjes:<br><br>Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se gjendja e pasurive jo financiare nën 1000€ të shpalosura në pasqyrat financiare vjetore në vlerë prej 160,890€ nuk përputhet me vlerën financiare të pasurive jofinanciare në | Gjetja: Ndonëse në nivel të përgjithshëm realizimi i buxhetit ishte 94%, Komuna nuk ka arritur të realizoj buxhetin për të gjitha kategoritë e shpenzimeve, ku posaçërisht ndryshimi më i theksuar është te kategoria e Investimeve kapitale me një realizim prej 83%, te shpenzimet komunale realizimi i buxhetit ishte 80% dhe te mallrat dhe shërbimet realizimi isht+e 89%. | mosrealizimit të buxhetit në disa kategori të caktuara , si dhe të siguroj një planifikim të drejtë buxhetor krahas projekteve të synuara dhe monitorim të performances buxhetore në baza të rregullta me qellim realizimit të buxhetit dhe evitimit të keqdeklarimeve. | tyre ne bazë të ndarjeve buxhetore në të gjitha kategoritë ekonomike të shpenzimeve te realizohen në shkallë sa më të lartë.<br><br>Monitorimi permanent e realizimit te projekteve kapitale do të zbatohet nga personat pergjegjes gjatë gjithë vitit ne menyrë që të arrihet shaklla e realizimit mbi 90% e projekteve kapitale. | Drejtoritë komunale, Zyrën e Prokurimit si dhe Menaxherëve të caktuar për mbikqyrje të projekteve. | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | regjistrin e pasurive për diferencën prej 135,951€. Po ashtu asetet kapitale janë të mbivlerësuara për vlerën prej 16,816€, duke u nënvlersuar asetet nën 1000€ (e-pasuria) si rezultat i keqklasifikimit. | | | | | | |
| 2 | | **Çështja C2-Niveli i ulët i inkasimit të të hyrave nga qeradhënia e pronave publike.**<br><br>**Gjetja:** Komuna ka dhënë me qira pronat komunale për shfrytëzim të përkohshëm. Nga të hyrat e planifikuara nga shfrytëzimi i pronës publike në shumë prej 30,000€, të hyrat e raportuara si të | Kryetari duhet të ndërmerr masa në rritjen e përgjegjësive të zyrtarit të shfrytëzimit të pronës publike me zyrtarin e të hyrave të cilët janë të obliguar të bëjnë barazimin e të hyrave në baza mujore. Po ashtu, Kryetari duhet të sigurojë se është bërë një rishikim i dosjeve të qiramarrësve, | Do të merren gjitha masat e duhura që inkasimi per shfrytezimin e pronës komunale të realizohet më për së afërmi me planifikimet, kjo do te arrihet me leshimin e verejtjeve tek shfrytezuesit e ketyre pronave ne fillim te vitit dhe te njejteve nuk do t'iu vazhdohet leja e shfrytezimit pa i kryer obligimet paraprake. | Drejtoria e Urbanizmit, Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor. | Janar – Dhjetor 2019 | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | inkasuara ishin vetëm 19,521€ apo 65% nga te planifikuarat. E hyra e raportuar nga kjo kategori ndryshon nga të hyrat e evidentuara në libra. Të hyrat nga shkarkimet e klienteve-pagesat janë në vlerë prej 16,682€, 1,500€ janë faljet e borxheve si dhe vlera prej 2,839€ është diferencë e konstatuar si mbivlerësim i të hyrave gjegjesisht mosshkarkim i pagesave të bëra nga klientët. Po ashtu, nga testet e realizura kemi gjetur se Komuna kishte vazhduar kontratat me qiramarrësit e pronës publike, edhe pse qiramarrësit nuk kishin kryer obligimet | kryesisht me qiramarrësit me të cilëve ju kanë vazhduar kontratat pa i kryer obligimet paraprake, dhe të vendos masat e duhura që brenda një periudhë të arsyeshme të inkasoj të gjitha obligimet e prapambetura. Gjithashtu, të krijoj dhe mbaj një evidencë të qartë dhe të kompletoj atë me të gjitha informatat e nevojshme në mënyrë që menaxhimi i të hyrave nga qiraja të jetë më efikas. | Bazur ne kartelat e borgjlinjëve, do të inicohen procedurat permbarimore te cilat lejohen me ligj, permes te cilave do te arrihet te permiresohet dukshem bilanci i realizimit te te hyrave nga qeraja publike.<br>Do të krijohet një evidencë më e saktë dhe e kompletuar me të gjitha informatat e nevojshme në mënyrë që menaxhimi i të hyrave nga qiraja të jetë më efikas. | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | paraprake. Komuna mbanë evidencë për pronat e dhëna me qira, mirëpo ato nuk janë të plota për të siguruar se të gjitha vlerat janë të llogaritura saktë dhe drejtë. Kësaj evidencë i mungonin informatat për salldon e bartur të borxhit nga viti paraprak si dhe informatat për datën e kontraktuar, përfshirë këtu edhe periudhën e shfrytëzimit të pronës komunale. | | | | | |
| 3 | | **Çështja A1- Mosrespektimi i legjislacionit lidhur me të punësuarit për shërbime të veçanta**<br><br>**Gjetja:** Gjate testimit të të punësuarve të ri, | Kryetari duhet të siguroj se duhet të respektuar të gjitha kërkesat ligjore lidhur me të punësuarit të rregullt dhe për të punësuarit për shërbime të veçanta. | Në të gjitha rastet e angazhimit te stafit për shërbime të veçanta do te respektohen dispozitat ligjore. Ne këtë fushë konsiderojmë se deri tani kemi respektuar kërkesat ligjore në | Zyra e Kryetarit, Drejtoritë përkatëse permes Zyrës së Personelit për secilën njësi kërkuese. | Janar – Dhjetor 2019 | Angazhimi i mjekëve specialist do të jetë sfidë edhe ne te ardhmen permes kontratave per |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | kemi konstatuar se raste kur pranimi në punë i të punësuarve për shërbime të veçanta është bërë pa shpallje të konkursit, në dy raste nuk ishin respektuar kërkesat që burojnë nga Ligji Nr. 03/L-212. Gjatë vitit 2018, në komunë ka pasur të punësuar për shërbime të veçanta për të cilët kohëzgjatja e tyre në punë nuk ishte në përputhje me legjislacionin, ku kohëzgjatja në punë ishte më shumë se 6 muaj. Bazuar në të gjeturat lidhur kohëzgjatjen në punë kemi konkluduar se Marrëveshjet për shërbime të veçanta nuk përputhen me | | shkallë tejet te lartë përveq dy rasteve nga gjithësej procedurat e zhvilluara pergjatë vitit 2018. Rastet per te cilat nuk eshte shpallur konkurs public, kanë qenë angazhimi i mjekëve për ofrimin e shërbimeve në QKMF. | | | sherbime te veçanta per te cilat eshte veshtirë të inicohen procedura rekrutimi. |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Legjislacionin, dhe po ashtu edhe për raste të caktuar nuk përputhen kërkesat ligjore lidhur me deklarimin e pagave. | | | | | |
| 4 | | **Çështja A2 Mbivlerësimi i investimeve kapitale**<br><br>**Gjetja**: Nga tri mostrat e testuara të kodit ekonomik 31620, kemi konstatuar se Pasuritë kapitale në PFV janë të mbivlerësuara për vlerën prej 16,816€ si rezultat i keqklasifikimit, e cila vlerë është dashur të regjistrohet ne kodin ekonomik 13501-pasuri jofinanciare nën 1000€ e që në këtë rast janë | Kryetari duhet të siguroj se janë marrë masa konkrete lidhur klasifikimin e shpenzimeve. | Rregullat e MFK-së do zbatohen ne pergjithesi. Do të respektohet në përpikëri pani kontabël. Regjistrimi i shpenzimeve do te behet ne kodet e caktuara. | Drejtoria e Financave permes ZKF dhe Zyrtarit zotues, shpenzues dhe çertifikuesit. | Mars – Dhjetor 2019 | Drejtoria për Ekonomi Financa dhe Zhvillim |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | nënvlerësuar për të njejtën vlerë. | | | | | |
| 5 | | **Çështja A3-Prokurimi-aneks kontratat**<br><br>Gjetja: Gjatë verifikimit të dosjeve të prokurimit për mallra dhe shërbime dhe investime kapitale, të gjitha dosjet e testuara kanë qenë me aneks kontrata kryesisht për vlerën 10% të kontratës. | Kryetari duhet të siguroj që procesi i planifikimit të prokurimit të bëhet në mënyrë profesionale, më i saktë dhe përzgjedhja e fituesve të jetë sa më reale. | Për qështjen e Aneks kontratave do te njoftohen gjitha njësitë kërkuese që puna shtesë të lejohet vetëm në raste të domosdoshme . Gjatë periudhës 01.01.2019 – 11.07.2019 janë reduktuar Aneks kontratat në 60% krahasuar me periudhen e njejtë te vitit te kaluar. Zyra e prokurimit në pashkëpunim me njësit kërkuese dhe ZKA janë të mendimit që vetëm aty ku është e domosdoshme të lejohet puna shtesë, kështu që do të mundohemi që të minimizojmë punën shtesë dhe të lejohet vetëm në ato raste të | Zyra e Prokurimit dhe Menaxherët e projekteve. | Janar – Dhjetor 2019 | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | cilat kanë një arsyeshmëri bindëse (të fortë). | | | |
| 6 | | **Çështja B2- Evidenca të mangëta për pasuritë më vlerë nën 1,000€**<br><br>Gjetja: Sipas rregullores mbi pasurinë jo financiare, pasuria nën 1,000€ dhe stoqet duhet të regjistrohen në sistemin E-pasuria. Komuna, për pasuritë më vlerë nën 1,000€ në PFV ka shpalosur Vlerën prej 160,890€. Nga testimi i blerjeve gjatë vitit 2018, kemi identifikuar se nuk ishin të regjistruar pasuritë jo kapitale të blera në vlerë totale 135,951€. Gjithashtu te | Kryetari duhet të sigurojë regjistrimin në kohë dhe të saktë të të gjitha pasurive në regjistrat përkatës, në përputhje me kërkesat e rregullores 02/2013. Gjithashtu duhet të sigurojë që pasuritë kapitale të cilat regjistrohen përmbajnë informacion të plotë, duke përfshirë datën kur pasuria është vënë në përdorim, në mënyrë që llogaritja e zhvlerësimit të mund të kryhet me saktësi, si dhe të përcaktojë | Nga zyrtari i pranimit të mallit dhe zyrtari i regjistrimit të pasurisë do të merren të gjitha masat për regjistrimin e pasurisë nën 1.000€ sipas rregullores 02/2013 duke kërkuar fillimisht paisjen me barkode dhe materiale tjera të ndryeshme qe nevojiten për identifikimin dhe regjistrimin e pasurisë.<br>Ne jemi zotuar dhe kemi filluar regjistrimin e aseteve në sistemin e-pasuria duke ju referuar rekomandimit të ZKA-së dhe gjendjes aktuale të pasurisë nën 1.000€ | Zyrtari i pranimit te mallit dhe zyrtari i regjistrimit te pasurisë | Janar – Dhjetor 2019 | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | pasuritë e regjistruara ka mungesë të informacioneve për data të regjistrimit, numrin e njësive, vlerat e tyre etj. Me tutje, Komisioni për inventarizimin vjetor të pasurive kapitale dhe jo kapitale nuk kishte bërë barazimin e regjistrave të inventarizimit me regjistra kontabël të mbajtur nga zyrtaret e pasurive. | statusin e pronësisë. Po ashtu gjendja e inventarizuar të krahasohet me regjistrin e përgjithshëm të pasurive, në mënyrë që diferencat e mundshme të identifikohen dhe më pas të pasqyrohen në regjistrat e pasurive. | Ne sigurojmë se regjistrimi i aseteve do të përfundoj shumë shpejt dhe në mënyrë profesionale duke përfshirë të gjitha shenimet (datën kur pasuria është vënë në përdorim), për llogaritjen e zhvlerësimin sa me real dhe me saktësi dhe të gjitha shenimeve të parapara në rregulloren 02/2013. | | | |
| | | | | | | | |
| 7 | | **Çështja A4- Harmonizimi i salldove të vitit paraprak me salldot fillestare**<br><br>**Gjetja:** Llogaritë e arkëtushme nga Shfrytëzimi i pronës publike- | Kryetari duhet të ndërmerr masa lidhur me sigurimin e një softueri i cili do të mundësonte mbajtjen e saktë të evidencës lidhur me llogaritë e | Do te behet barazimi i sakte i evidencav lidhur me regjistrimin e te hyrave nga taksa e shfrytezimit te prones publike si dhe takses se veprimtarise se bizneseve. | Drejtoria për Ekonomi Financa dhe Zhvillim<br><br>Zyrtari i tehyrave dhe zyrtaret e përgjegjes për perllogaritjen | Janar – Dhjetor 2019 | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Kodi 50405 sipas Auditimit, Salldo e raportuar me 31.12.2017 është në vlerë prej 75,860€, ngarkesa në libra për vitin 2018 në vlerë prej 21,239€, duke zbritur shkarkimet e raportuara me pagesa të klientëve për vitin 2018 në vlerë prej 19,521€ si dhe duke zbritur shumën e stornuar-falur me vendim në shumë prej 1,500€, Salldo e mbetur për raportim për vitin 2018 kapë shumën prej 76,308€ €, derisa është raportuar vetëm 35,120€ Me çka kemi nënvlersim me rastin e të arkëtushmëve të kësaj kategorie në shumën prej 41,188€. | arkëtueshme, kategorizimin e tyre sipas vjetërsisë dhe bartjen e saktë të salldove të tyre në vitin në vijim. | | dhe inkasimin e te hyrave perkatese. | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 8 | | **Çështja C3- Mungesa e mekanizmave për inkasimin e të arketueshmeve**<br><br>**Gjetja:** Përkundër faktit se Komuna ka ndërmarr masa aktive lidhur me inkasimin e llogarive të arkëtueshme, të arkëtueshmet kanë trend rritës krahasuar me vitin paraprak. Rritja e të arketueshmeve ndër vite paraqet jo efikasitet në mbledhjen e borxheve, sidomos borxheve të vjetra të bartura ndër vite. | Kryetari duhet të ndërmerr masa për të shqyrtuar shkaqet për dështim të inkasimeve të llogarive të arkëtueshme dhe të siguroj mekanizma efektiv për mbledhjen e tyre. Po ashtu, Kryetari duhet të sigurojë se është bërë një rishikim i dosjeve të qiramarrësve, kryesisht me qiramarrësit me të cilëve ju kanë vazhduar kontratat pa i kryer obligimet paraprake, dhe të vendos masat e duhura që brenda një periudhë të arsyeshme të inkasoj të gjitha obligimet e prapambetura dhe të inicoj proces të rivleresimit të | Përmes shfrytëzimit të të gjitha veprimeve të nevojshme në kuadër të komunës, do të ndërmirren masat e nevojshme ligjore për të siguruar inkasimin e tyre, në mënyrë qe saldoja e llogarive të arkëtueshme të zvogëlohet.<br><br>Njëra prej masave më të reja të cilat kanë filluar të ndërmarren me fillim te vitit 2019 janë masat e inicuara permbarimore. | Drejtoritë të cilat realizojnë të hyra permes zyrtareve përgjegjës | Janar – Dhjetor 2019 | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | llogarive të arkëtueshme, ku të gjitha llogarite do të analizohen në kuptimin e vjetërsise, shumave domethënëse dhe mundësive reale për inkasimin e tyre, e në raste të caktuara të bëhet provizionimi apo shlyerja e tyre në rast të kategorizimit si borxhe të këqija. | | | | |
| 9 | | **Çështja C4- Mos zbatueshmëria e rekomandimeve të auditimit të brendshëm**<br><br>**Gjetja**: Nga gjithsej 20 rekomandime të dhëna, vetëm tetë ishin zbatuar plotësisht, tetë ishin në proces të zbatimit ndërsa kater kanë mbetur të pazbatuara. Periudha të cilën e mbulonin | Kryetari të siguroj se, plani i NjAB-së të zbatojë një qasje ndaj fushave me rrezik duke ndihmuar aktivitetet operative në vazhdim, si dhe një fokus më të lartë të menaxhmentit në adresimin e rekomandimeve, në mënyrë që përfitimet nga auditimi i | Do të rritet bashkëpunimi me Njesinë e Auditimit të Brendshëm dhe do te behen perpjekjet e duhura per zbatim te rekomandimeve te dalura nga NJAB. | Gjitha njesitë organizative brenda komunes. | Janar – Dhjetor 2019 | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | rekomandimet e dhëna, me theks të veçantë për fushën e prokurimit, kryesisht kishte të bëjë me vitin paraprak. Moszbatimi i rekomandimeve të dhëna, tregon një mungesë të vullnetit të menaxhmentit për marrjen e përfitimeve nga auditimi i brendshëm dhe sigurisë mbi funksionimin e kontrolleve të brendshme. | brendshëm të jenë sa më të larta. | | | | |
| 10 | | **Çështja B3 - Dobësi në kontrollet menaxheriale dhe menaxhimin e rrezikut**<br><br>**Gjetja**: Si pasojë e kontrolleve të pamjaftueshme menaxheriale, një pjesë e konsiderueshme e buxhetit për | Kryetari duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë. Ecuritë buxhetore, duke përfshirë të hyrat | Përkushtim të veçant do ti kushtohet trajtimit të llogarive të arkëtueshme, përcjelljes së ecurisë financiare të aktiviteteve tek te gjitha kategoritë ekonomike të shpenzimeve me focus te veçantë te | Të gjithë mbajtësit e buxheteve dhe njësitë tjera organizative. | Janar – Dhjetor 2019 | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | investime kapitale dhe mallra e shërbime nuk është shpenzuar. Llogaritë e arkëtueshme nuk ishin trajtuar në mënyrën e duhur nga ana e menaxhmentit si dhe nuk ishte bërë regjistrimi i pasurisë e as inventarizimi i plotë i pasurisë. Menaxhmenti po ashtu nuk posedon analiza të rregullta periodike për ecuritë buxhetore, nuk rishqyrton planin e prokurimit dhe nuk ka raporte të rregullta të detajuara për aktivitetet operative. Komuna gjithashtu nuk ka politika të shkruara dhe procedura për menaxhimin e rreziqeve, në veçanti rrezikut të mashtrimit dhe parregullsive. Nuk | dhe shpenzimet, dhe plani i prokurimit duhet të jenë subjekt i raportimeve dhe rishikimeve të rregullta nga ana e menaxhmentit, procesi i regjistrimit dhe inventarizimit duhet të përfshinë gjithë pasurinë komunale. Gjithashtu, për të reduktuar ndikimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, organizata duhet të hartoj regjistrin e rreziqeve me të gjitha masat/veprimet e duhura për të vendosur nën kontroll kërcënimet e ekspozuara. | 'KE' mallra e sherbime dhe investime kapitale, rishqyrtim I planit te prokurimit, etj.<br><br>Ndersa analizat buxhetore ne baza periodike do të përmiresohen ende edhe pse ato nuk kanë munguar edhe në baza ditore, te cilat I kemi siguruar dhe raportuar tek menaxhmenti i lartë permes sistemit te FRRE BALANCIT. | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | ekziston ndonjë regjistër i rreziqeve i hartuar sipas kërkesave të MFK-së, nuk ka strategji për menaxhimin e rrezikut, dhe as që përgatitet ndonjë raport për menaxhimin e tyre | | | | | |

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

**01 Nr. 400/01-22496/19**
**Kaçanik, 30.07.2019**

Mbështetur në nenin 40.2 (b.) të Ligjit nr.03/L-040 – Për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare Nr. 28/4 Qershor 2008), të Ligjit Nr.03/L-048 – Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të Ligjit Nr. 03/L-221- Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-048- Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të nenit 15 dhe 16 të Ligjit Nr. 06/L-133- Për Buxhetin e Republikës së Kosovës 2019, të nenit 34.5 lidhur me nenin 61 të Statutit të Komunës së Kaçanikut, duke vendosur sipas Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës 01Nr. 400/01-22496/19 të datës 18.07.2019, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e mbajtur me 30 Korrik 2019, mori këtë:

# V E N D I M
# PËR RIALOKIMIN DHE TRANSFERIN E MJETEVE BUXHETORE SIPAS BUXHETIT TË VITIT 2019

**1. Transferi i mjeteve buxhetore nga Kategoria e Investimeve Kapitale- burimi i financimit Grant Qeveritar (10);**
Në kuadër të Nën-programit buxhetor –Planifikim Urban dhe Inspekcioni (66445) kodi funksional (0620) nga projekti kapital me kod 46807 "Rrënimi i obj. dhe largimi i deponive ilegale" shuma prej 3.000.00€
→ **Transferohen**: Në kategorinë e Investimeve Kapitale në Nën Programin buxhetor (18028) Infrasturktura rrugore, në projektin me kod 46530 " Ndërtimi i rrugëve në fshatin Biçec" shuma prej 3.000.00€.

**2. Ri-alokimi i mjeteve nga Kategoria e Investimeve Kapitale –burimi i financimit Grant qeveritar (10);**
Në kuadër të Nën-programit buxhetor –Infrastruktura rrugore (18028) kodi funksional (0451) nga kodi i projektit kapital 46672 " Ndërtimi dhe Asfaltimi i rrugëve në fshatin Gllobоçicë", shuma, 7.800.00€, kodi i projektit kapital 46545" Rregullimi i infrastrukturës në fshatin Bob", shuma 1,811.00€ dhe kodi i projektit kapital 43981" Ndërtimi i rrugëve në fshatin Stagovë, shuma prej 152,58€
→**Rialokohet** në Nën-programin buxhetor - Infrastruktura rrugore (18028) kodi funksional (0451) në projektin kapital me kod 46530 " Ndërtimi i rrugëve në fshatin Biçec" shuma prej 9,764.00€.

**3. Rialokimi i mjeteve nga Kategoria e Investimeve Kapitale- burimi i financimit , të Hyrat Vetanake (21);**
Në kuadër të Nën-Programit buxhetor-Infrastruktura rrugore ( 18028) kodi funksional (0451) nga kodi i projektit kapital 46672 " Ndërtimi dhe Asfaltimi i rrugëve në fshatin Gllobоçicë, shuma prej 5,000.00€
→**Rialokohet:** Në Nën-Programin buxhetor- Infrastruktura rrugore (18028) kodi funksional (0451) në projektin kapital me kod 46530 " Ndërtimi i rrugëve në fshatin Biçec" shuma prej 5,000.00€.

**4.** Pjesë përbërëse e këtij Vendimi janë, Formularët standard nga MF, të plotësuara me shumat e lëvizura sipas Nën-Programeve buxhetore dhe kodeve ekonomike të shpenzimeve.

**5.** Për realizimin e këtij Vendimi, obligohet Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, e cila drejtori të njëjtin vendim do ta zbaton në Ministrinë e Financave, respektivisht në Departamentin e Buxhetit dhe Departamentin e Thesarit.

**6.** Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës - MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në Faqen Zyrtare të Komunës.

**Me këtë Vendim të njoftohen:**

1. Kryetari i Komunës( përmes Zyrës së Kryetarit, njoftohen organet të tjera relevante )
2. Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit; dhe
3. Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E KAÇANIKUT OPŠTINA KAČANIK REPUBLIKA KOSOVA

**Republika e Kosovës**

**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**Qeveria - Vlada - Government**

*Ministria e Financave*
*Ministrarstvo za Financije - Ministry of Finance*
***Departamenti i Buxhetit-Budzet Department-Budget Departament***

# KËRKESA PËR RIALOKIM

**PJESA 1: TË DHËNAT E RIALOKIMIT**

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Emri i organizatës buxhetore** | | **Kodi** | |
| **Emri i nën-programit** | **Infrastruktura rrugore** | **Kodi** | **18028** |

**Rialokimi**

| Kodi organizativ | Kodi i nën-programit | Kodi Funksional | Burimet e Financimit | Emërtimi i Projektet | Kodi i projektit | Kategoria shpenzimeve | Aprovimi i tanishëm | Shuma e ndryshimit | Aprovimi i ri | Buxheti Aprovuar/Rishikuar | Totali i shumës së transferuar/rialokuar | % Transferit/ Rialokimit (i ri ndaj buxhetit) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 652 | 180/18028 | 0451 | 21 | Ndertimi dhe asfaltimi i rrugeve ne fshatin Glloboqicë | 46672 | 30 | 10,000.00 | (5,000.00) | 5,000.00 | 5,000.00 | (5,000.00) | (50) |
| 652 | 180/18028 | 0451 | 21 | Ndertimi i rrugeve ne fshatin Biqec | 46530 | 30 | - | 5,000.00 | 5,000.00 | 5,000.00 | 5,000.00 | - |
| | | | | **Totali** | | | **10,000** | **(5,000)** | **5,000** | **5,000** | **(5,000)** | **(50)** |

**PJESA 2: ALOKIMI I NDARJES BUXHETORE TË RIALOKUARA**

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | PO | JO |
| (Shëno Po ose Jo) | **Rialokimi të pasqyrohet në ndryshimet e alokimeve** | PO | |
| | **Konfirmo që është dhënë plani i rishikuar i rrjedhës së parasë?** | PO | |

**PJESA 3: ARSYETIMI (Të plotësohet nga organizata buxhetore)**

Arsyeja e barjes se mjeteve te kursyera nga projektet e lartecekura te projekti "Ndertimi i rrugeve ne fshatin Biqec" eshte nevoja e plotesimit te buxhetit per kete projekt ngase sipas parallogarive aktuale shuma e mbetur nga faza e pare ne kete projekt nuk mundeson realizimin e plote te fazes se dyte te projektit "Rregullimi i rruges Koraq-Bunjak".

ORGANIZATA BUXHETORE CERTIFIKON QË KËRKESA ËSHTË KONSISTENTE ME LIGJIN E BUXHETIT DHE PËRFAQËSON PËRDORIM EFEKTIV DHE EFIKAS TË FONDEVE, KONSISTENT ME OBJEKTIVAT BUXHETORE TË ORGANIZATËS

| **Zyrtari kryesor financiar** | **Data** | **Zyrtari Kryesor Administrativ / Kryeshefi Ekzekutiv** | **Data** |
|---|---|---|---|
| **Bahri Selimi** | **19.07.2019** | **Besim Ilazi** | **19.07.2019** |

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E KAÇANIKUT OPSTINA KAČANIK REPUBLIKA KOSOVA

**PJESA 4: ANALIZA DHE APROVIMI**

**ANALIZA E MF (Të plotësohet nga analisti i buxhetit)**

| | | | |
|---|---|---|---|
| **KËRKO NDRYSHIMET NË NDARJE BUXHETORE** | | **NDARJA BUXHETORE KD E REGJISTRUAR NË SIMFK NGA*** | |
| **Drejtor i Buxhetit** | **Data** | **Departamenti i buxhetit regjistrimi i të dhënave*** | **Data** |
| Salvador Elmazi | | | |
| | | **NUMRAT E KD** | |

**Vrejtje:**
*Kolona e hijezuar paraqet totalin e ndarjes buxhetore për kategorin e shpenzimeve të nën-programit

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
**Qeveria - Vlada - Government**

*Ministria e Financave*
*Ministrarstvo za Financije - Ministry of Finance*
*Departamenti i Buxhetit-Budzet Department-Budget Departament*

# KËRKESA PËR RIALOKIM

## PJESA 1: TË DHËNAT E RIALOKIMIT

| | | | |
|---|---|---|---|
| Emri i organizatës buxhetore | | Kodi | |
| Emri i nën-programit | Infrastruktura rrugore | Kodi | 18028 |

**Rialokimi**

| Kodi organizativ | Kodi i nën-programit | Kodi Funksional | Burimet e Financimit | Emërtimi i Projektet | Kodi i projektit | Kategoria shpenzimeve | Aprovimi i tanishëm | Shuma e ndryshimit | Aprovimi i ri | Buxheti Aprovuar/Rishikuar | Totali i shumës së transferuar/rialokuar | % Transferit/ Rialokimit (i ri ndaj buxhetit) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 652 | 180/18028 | 0451 | 10 | Ndertimi dhe asfaltimi i rrugeve ne fshatin Gllobogicë | 46672 | 30 | 50,000.00 | (7,800.00) | 42,200.00 | 42,200.00 | (7,800.00) | (15.60) |
| 652 | 180/18028 | 0451 | 10 | Ndertimi i rrugeve ne fshatin Biqec | 46530 | 30 | 30,000.00 | 7,800.00 | 37,800.00 | 37,800.00 | 7,800.00 | - |
| 652 | 180/18028 | 0451 | 10 | Rregullimi i infrastruktures ne fshatin Bob | 46545 | 30 | 20,000.00 | (1,811.00) | 18,189.00 | 18,189.00 | (1,811.00) | (9.06) |
| 652 | 180/18028 | 0451 | 10 | Ndertimi i rrugeve ne fshatin Biqec | 46530 | 30 | 30,000.00 | 1,811.00 | 31,811.00 | 31,811.00 | 1,811.00 | - |
| 652 | 180/18028 | 0451 | 10 | Ndertimi I rrugeve ne fshatin Stagovë | 43981 | 30 | 20,000.00 | (152.58) | 19,847.42 | 19,847.42 | (152.58) | (0.76) |
| 652 | 180/18028 | 0451 | 10 | Ndertimi i rrugeve ne fshatin Biqec | 46530 | 30 | 30,000.00 | 152.58 | 30,152.58 | 30,152.58 | 152.58 | - |
| | | | | **Totali** | | | 90,000 | (9,764) | 80,236 | 80,236 | (9,764) | (10.85) |

## PJESA 2: ALOKIMI I NDARJES BUXHETORE TË RIALOKUARA

| | | | |
|---|---|---|---|
| (Shëno Po ose Jo) | | PO | JO |
| | Rialokimi të pasqyrohet në ndryshimet e alokimeve | PO | |
| | Konfirmo që është dhënë plani i rishikuar i rrjedhës së parasë? | PO | |

## PJESA 3: ARSYETIMI (Të plotësohet nga organizata buxhetore)

Arsyeja e barjes se mjeteve te kursyera nga projektet e lartecekura te projekti "Ndertimi i rrugeve ne fshatin Biqec" eshte nevoja e plotesimit te buxhetit per kete projekt ngase sipas parallogarive aktuale shuma e mbetur nga faza e pare ne kete projekt nuk mundeson realizimin e plote te fazes se dyte te projektit "Rregullimi i rruges Koraq-Bunjak".

ORGANIZATA BUXHETORE CERTIFIKON QË KËRKESA ËSHTË KONSISTENTE ME LIGJIN E BUXHETIT DHE PËRFAQËSON PËRDORIM EFEKTIV DHE EFIKAS TË FONDEVE, KONSISTENT ME OBJEKTIVAT BUXHETORE TË ORGANIZATËS

| Zyrtari kryesor financiar | Data | Zyrtari Kryesor Administrativ / Kryeshefi Ekzekutiv | Data |
|---|---|---|---|
| Bahri Selimi | 19.07.2019 | Besim Ilazi | 19.07.2019 |

REPUBLIKA E KOSOVËS / KOMUNA E KAÇANIKUT / OPŠTINA KAČANIK / REPUBLIKA KOSOVA

## PJESA 4: ANALIZA DHE APROVIMI

ANALIZA E MF (Të plotësohet nga analisti i buxhetit)

| | | | |
|---|---|---|---|
| KËRKO NDRYSHIMET NË NDARJE BUXHETORE | | NDARJA BUXHETORE KD E REGJISTRUAR NË SIMFK NGA* | |
| **Drejtor i Buxhetit** | Data | Departamenti i buxhetit regjistrimi i të dhënave* | Data |
| Salvador Elmazi | | NUMRAT E KD | |

Vrejtje:
*Kolona e hijezuar paraqet totalin e ndarjes buxhetore për kategorin e shpenzimeve të nën-programit

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
**Qeveria - Vlada - Government**

*Ministria e Financave*
*Ministrarstvo za Financije - Ministry of Finance*
***Departamenti i Buxhetit-Budzet Department-Budget Departament***

# KËRKESA PËR TRANSFER

**PJESA 1: TË DHËNAT E TRANSFERIT**

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Emri i organizatës buxhetore** | **Komuna Kaçanikut** | **Kodi** | **652** |
| **Emri i nën-programit** | **Planifikimi Urban dhe Mjedisi** | **Kodi** | **66445** |

**Transferi/Rialokimi**

| Kodi organizativ | Kodi i nën-programit | Kodi Funksional | Burimet e Financimit | Emërtimi i Projektet | Kodi i projektit | Kategoria shpenzimeve | Aprovimi i tanishëm | Shuma e ndryshimit | Aprovimi i ri | Buxheti Aprovuar/Rishikuar | Totali i shumës së transferuar/rialokuar | % Transferit/ Rialokimit (i ri ndaj buxhetit) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 652 | 660/66445 | 0620 | 10 | Rrenimi I obj. dhe largimi i deponimeve ilegale | 46807 | 30 | 20,000 | (3,000) | 17,000 | 14,000 | (3,000) | **(15.00)** |
| 652 | 180/18028 | 0451 | 10 | Ndertimi i rrugeve ne fshatin Biqec | 46530 | 30 | 30,000 | 3,000 | 33,000 | 30,000 | 3,000 | |
| | | | | **Totali i nën-programit** | | | **20,000** | **(3,000)** | **17,000** | **14,000** | **(3,000)** | **(15.00)** |
| 652 | 660/66445 | 0620 | 1/10/1900 | Rrenimi I obj. dhe largimi i deponimeve ilegale | 46807 | 30 | 20,000 | (3,000) | 17,000 | 20,000 | (3,000) | -15.00% |

**PJESA 2: ALOKIMI I NDARJES BUXHETORE TË TRANSFERUAR**

| | | | |
|---|---|---|---|
| (Shëno Po ose Jo) | | PO | JO |
| | **Transferi të pasqyrohet në ndryshimet e alokimeve** | PO | |
| | **Konfirmo që është dhënë plani i rishikuar i rrjedhës së parasë?** | PO | |

**PJESA 3: ARSYETIMI (Të plotësohet nga organizata buxhetore)**

Arsyeja e barjes se mjeteve te kursyera nga projektet e lartecekura te projekti "Ndertimi i rrugeve ne fshatin Biqec" eshte nevoja e plotesimit te buxhetit per kete projekt ngase sipas parallogarive aktuale shuma e mbetur nga faza e pare ne kete projekt nuk mundeson realizimin e plote te fazes se dyte te projektit "Rregullimi i rruges Koraq-Bunjak".

ORGANIZATA BUXHETORE CERTIFIKON QË KËRKESA ËSHTË KONSISTENTE ME LIGJIN E BUXHETIT DHE PËRFAQËSON PËRDORIM EFEKTIV DHE EFIKAS TË FONDEVE, KONSISTENT ME OBJEKTIVAT BUXHETORE TË ORGANIZATËS

| Zyrtari kryesor financiar | Data | Zyrtari Kryesor Administrativ / Kryeshefi Ekzekutiv | Data |
|---|---|---|---|
| **Bahri Selimi** | **19.07.2019** | **Besim Ilazi** | **19.07.2019** |

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E KAÇANIKUT OPŠTINA KAČANIK REPUBLIKA KOSOVA

**PJESA 4: ANALIZA DHE APROVIMI**

**ANALIZA E MF (Të plotësohet nga analisti i buxhetit)**

| | | | |
|---|---|---|---|
| **KËRKO NDRYSHIMET NË NDARJE BUXHETORE** | | **NDARJA BUXHETORE KD E REGJISTRUAR NË SIMFK NGA*** | |
| **Drejtor i Buxhetit** | **Data** | **Departamenti i buxhetit regjistrimi i të dhënave*** | **Data** |
| Salvador Elmazi | | **NUMRAT E KD** | |

**Vrejtje:**
***Kolona e hijezuar paraqet totalin e ndarjes buxhetore për kategorin e shpenzimeve të nën-programit**

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

KAÇANIKU

Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

*01Nr. 60/01-18735/19*
*Kaçanik, 30. 07.2019*

Në bazë të nenit 12.2 (d) lidhur me nenin 73 të Ligjit Nr. 03/L-040 -Për Vetëqeverisjen e Lokale (Gazeta Zyrtare Nr. 28/04 Qershor 20108) , të nenit 8 lidhur me nenet 4, 5, 7 dhe 9 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 01/2016 -Për procedurën e themelimit, organizimit dhe kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna, të nenit 31, 32 lidhur me nenin 39.3 të Statutit të Komunës, duke iu referuar Raportit final të Rekomandimit nga Paneli Përzgjedhës të datës 19 Korrik 2019, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur me 30 Korrik 2019, mori këtë:

# VENDIM

## PËR ZGJEDHJEN E ANËTARËVE TË KOMITETIT KONSULTATIV PËR PERSONA ME AFTËSI TË KUFUZUARA NË KOMUNËN E KAÇANIKUT TË FORMUAR ME VENDIM TË KUVENDIT TË KOMUNËS 01Nr. 104/02-34370/18 ME 30 TETOR 2018

1. Me këtë Vendim, zgjedhën anëtarët e Komitetit konsultativ për persona me aftësi të kufizuara në Komunën e Kaçaniku, të themeluar me Vendim të Kuvendit të Komunës 01Nr. 104/02-34370/18 të datës 30 Tetor 2018, në përbërje prej 7 anëtarëve, si vijon:
   1.1. Argjenta Axhami,
   1.2. Artan Mezraja,
   1.3. Mirlinda Axhami-Hysa,
   1.4. Fiknete Krasniqi,
   1.5. Edita Shehu,
   1.6. Albana Fuga, dhe
   1.7. Antigona Axhami-Baftijaj.

2. Kryesuesi i Komitetit Konsultativ zgjidhet nga radhët e anëtarëve të përcaktuar si në pikën 1 të këtij vendimi.

3. Kompetencat e Komiteteve Konsultative janë: Dhënia e propozim rregulloreve të ndryshme, hulumtime të ndryshme, mendime dhe ide rreth iniciativave të Kryetarit të Komunës, Komiteteve të Përhershme apo Kuvendit të Komunës në fushën përkatëse, paraqitjen e pikëpamjeve dhe mendimeve të qytetarëve të Kryetari i Komunës dhe Kuvendi i Komunës, propozime për zgjedhjen e problemeve të identifikuara, propozime këto të cilat nuk janë obliguese për

Kuvendin e Komunës, por duhet të merren parasysh në zhvillimin e politikave komunale.

4. Mandati i anëtarëve të Komitetit Konsultativ të përcaktuar si në pikën 1 të këtij vendimi është 4 vjeçar.
   4.1. Anëtarët e Komitetit Konsultativ nuk mund të shërbejnë me tepër së dy mandate të njëpasnjëshme si anëtarë të këtij komiteti.

5. Për punën e vetë, Komiteti Konsultativ obligohet të dorëzoj Kuvendit të Komunës Raport vjetor.

6. Për punën që kryejnë anëtarët e komitetit konsultativ do të kompensohen në proporcion me mëditjet e anëtarëve të Komiteteve të përhershme, por jo më shumë se 6 mbledhje brenda një viti.

7. Çështjet të tjera që nuk janë përcaktuar me këtë vendim, si mënyra e funksionimit, shkarkimi dhe largimi i anëtarëve të Komitet Konsultativ janë të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ Nr. 01/2016 - Për procedurën e themelimit, organizimit dhe kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna.

8. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Kuvendi i Kuvendit dhe Kryetari i Komunës.

9. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës -MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në Faqen zyrtare të komunës.

**Me këtë Vendim njoftohen:** MAPL, Kryetari i Komunës, Anëtarët e Komitetit Konsultativ, Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim dhe Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli

REPUBLIKA E KOSOVËS · KOMUNA E KAÇANIKUT · REPUBLIKA KOSOVA · OPŠTINA KAČANIK

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

KAÇANIKU

Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assambly

## RAPORTI FINAL I REKOMANDIMIT NGA PANELI PËRZGJEDHËS

Për; Kuvendin e Komunës
Nga: __ Murat Burrniku
*(Kryesues I Panelit )*
Numri i references së postit : 01 Nr 111/01-14845/19
Titulli i vendit të punës : Anëtar të komitetit konsultativ për (PAK)

Është bashkangjitur përzgjedhja përfundimtare e kandidatëve të renditur, për vendin e punës "_ Anëtar të komitetit konsultativ për (PAK) _, testet për përzgjedhjen përfundimtare janë mbajtur më 19.07.2019 në ora _10:00__. Paneli përzgjedhës përbëhet nga (emrat dhe titujt e anëtarve të komisionit):

1. Murat Burrniku - Kryesues I Panelit përzgjedhës
2. Kadri Krivenjeva – anëtar
3. Shpend Krusha -anëtar
4. Besnik Salihu – anëtar
5. Sebahate Elezi - Anëtare

Numri __13__ i aplikacioneve për vendin e punës që kanë konkurruar, prej të cilëve 13 kandidat kanë hyrë në listën e ngushtë dhe janë ftuar të marrin pjesë në testimin me shkrim. Dymbëdhjet (12)_kandidat kanë qenë prezent,dhe janë testuar.Testimi me shkrim është mbajtur më 17.07.2019 në ora 10:00, testin me shkrim e ka kalur nëntë (9) kandidat, kandidatët të cilët e kanë kaluar testimin me shkrim janë ftuar në testimin me gojë. Testimi me gojë është mbajtur më 19.07.2019, dhe para panelit përzgjedhës kanë prezentuar Dymbëdhjet (12)_kandidat

Paneli përzgjedhës rekomandon se këto kandidat në bazë të meritës do të emërohen në pozitën , **Anëtar të komitetit konsultativ për (PAK) :**

| | |
|---|---|
| 1. | **ARGJENTA AXHAMI** |
| 2. | **ARTAN MEZRAJA** |
| 3. | **MIRLINDA HYSA** |
| 4. | **FIKNETE KRASNIQI** |
| 5. | **EDITA SHEHU** |
| 6. | **ALBANA FUGA** |
| 7. | **ANTIGONA AXHAMI-BAFTIJAJ** |

Të bashkangjitur dokumentet vijuese

- Shpallja dhe përshkrimi i vendit të punës
- Lista e aplikantëve
- Kriteret për zgjedhjen e ngushtë
- Lista e kandidatëve nga përzgjedhja e ngushtë
- Formularët e vlerësimit individual nga testimet, prej secilit anëtarë të komisionit
- Formulari i përmbledhjes së vlerësimeve individuale nga testimet

Murat Burrniku – Zyrtar I personelit - Kryesues i Panelit
Kadri Krivenjeva – Anëtar I Panelit
Shpend Krusha - Anëtar I Panelit
Besnik Salihu - Anëtar I Panelit
Sebahate Elezi - Anëtar I Panelit

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

KAÇANIKU

Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assambly

**Komiteti Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara**
**01Nr.60/01-18735/19**
**Kaçanik; 19.07.2019**

## NJOFTIM PËR KANDIDATËT E SUKSESSHËM

Paneli përzgjedhës i formuar për zhvillimin e procedurës së rekrutimit për vendin e punës "Anëtarë të Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara"- shtatë (7) anëtarë, në bazë të raportit për procedurën e konkursit : "Anëtar të Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara"- shtatë (7) anëtarë, Kryesuesi panelit bënë njoftimin për kandidatët e suksesshëm të rekomanduar nga paneli përzgjedhës, pas përfundimit të procedurës së rekrutimit për pozitën "Anëtar të Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara"- shtatë (7) anëtarë" sipas konkursit 01Nr.111/01-18735/19 të publikuar më 28.06.2019.

Titulli i vendit të punës: "ANËTAR TË KOMITETIT KONSULTATIV PËR PERSONA ME AFTËSI TË KUFIZUARA"- SHTATË (7) ANËTARË

Emri dhe mbiemri:
1. **ARGJENTA AXHAMI**
2. **ARTAN MEZRAJA**
3. **MIRLINDA AXHAMI – HYSA**
4. **FIKNETE KRASNIQI**
5. **EDITA SHEHU**
6. **ALBANA FUGA**
7. **ANTIGONA AXHAMI – BAFTIJAJ**

**Këshillë juridike**: Kandidatët e pakënaqur të cilët kanë aplikuar për këtë vend pune kanë të drejtë ankese komisionit për zgjedhjen e kontesteve dhe ankesave në afat prej 8 ditë nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

REPUBLIKA E KOSOVËS * KOMUNA E KAÇANIKUT * OPŠTINA KAČANIK * REPUBLIKA KOSOVO

**Kryesuesi i panelit**
Murat Burrnika

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

KAÇANIKU

Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assambly

**Komiteti Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara**
**01Nr.60/01-18735/19**
**Kaçanik; 19.07.2019**

## NJOFTIM PËR KANDIDATËT E SUKSESSHËM

Paneli përzgjedhës i formuar për zhvillimin e procedurës së rekrutimit për vendin e punës "Anëtar të Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara"- shtatë (7) anëtarë, në bazë të raportit për procedurën e konkursit : "Anëtar të Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara"- shtatë (7) anëtarë, Kryesuesi panelit bënë njoftimin për kandidatët e suksesshëm të rekomanduar nga paneli përzgjedhës, pas përfundimit të procedurës së rekrutimit për pozitën "Anëtar të Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara"- shtatë (7) anëtarë" sipas konkursit 01Nr.111/01-18735/19 të publikuar më 28.06.2019.

Titulli i vendit të punës: "ANËTAR TË KOMITETIT KONSULTATIV PËR PERSONA ME AFTËSI TË KUFIZUARA"- SHTATË (7) ANËTARË

Njoftojmë kandidatët se kanë fituar këto pikë me përqindje

Emri dhe mbiemri:
1. **ARGJENTA AXHAMI -** ( 89.75 % - pikë të fituara)
2. **ARTAN MEZRAJA -** ( 89.50% - pikë të fituara)
3. **MIRLINDA AXHAMI – HYSA -** ( 88.0 % - pikë të fituara)
4. **FIKNETE KRASNIQI -** ( 81.63 % - pikë të fituara)
5. **EDITA SHEHU** - ( 72.38 % - pikë të fituara)
6. **ALBANA FUGA -** ( 70.63 % - pikë të fituara)
7. **ANTIGONA AXHAMI – BAFTIJAJA -** ( 67.50 % - pikë të fituara)
8. **GYNER GASHI** - ( 63.50 % - pikë të fituara)
9. **DURESA SHEHU – NIKOCI** - ( 57.13 % - pikë të fituara)

Procedura e rekrutimit përfundon zyrtarisht pas aprovimit nga Kuvendi i Komunës

**Këshillë juridike**: Kandidatët e pakënaqur të cilët kanë aplikuar për këtë vend pune kanë të drejtë ankese komisionit për zgjedhjen e kontesteve dhe ankesave në afat prej 8 ditë nga dita e publikimit të njoftimit për kandidatin e përzgjedhur.

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E KAÇANIKUT OPŠTINA KAČANIK REPUBLIKA KOSOVO

**Kryesuesi i panelit**
Murat Burrniku

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

KAÇANIKU

Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assambly

**RENDITJA PËRFUNDIMTARE E KANDIDATËVE**

Titulli i pozitës Anëtar të komitetit konsultativ për (PAK)

Nr. i referencës 01Nr.60/01-18735/19

Kandidatët nga lista e ngushtë janë testuar me shkrim më 17.07.2019 dhe janë intervistuar me gojë më 19.07.2019 dhe janë renditur sipas cilësive të vlerësuar sipas kritereve të përzgjedhur dhe të miratura

| Nr i aplikacionit | Emri dhe mbiemri | Pikët totale të fituara |
|---|---|---|
| 01-103/02-220838/19 | ARGJENTA AXHAMI | 718 |
| 01-103/02-21348/19 | ARTAN MEZRAJA | 716 |
| 01-103/02-21254/19 | MIRLINDA HYSA | 704 |
| 01-103/02- 21468/19 | FIKNETE KRASNIQI | 653 |
| 01-103/02-21430/19 | EDITA SHEHU | 579 |
| 01-103/02-20399/19 | ALBANA FUGA | 565 |
| 01-103/02-20581/19 | ANTIGONA AXHAMI-BAFTIJAJ | 540 |
| 01-103/02-20215/19 | GYNER GASHI | 508 |
| 01-103/02-21334/19 | DURESA SHEHU- NIKOCI | 457 |
| | | |
| | | |
| | | |
| | | |
| | | |
| | | |

Nëshkrimi i kryesuesit dhe anëtarëve të Komisionit

1. ________ 2. ________ 3. ________ 4. ________ 5. ________

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

KAÇANIKU

Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assambly

## PËRMBLEDHJA E VLERËSIMEVE INDIVIDUALE

Titulli i pozitës: Anëtar të komitetit konsultativ për (PAK)
Numri i referencës së Pozitës: 01Nr.60/01-18735/19

| Nr i aplikacionit | Emri i kandidatit | Pikët e vlerësuara nga anëtarët e Komisionit | | | | | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | A-1 | A-2 | A-3 | A-4 | A-5 | |
| 01-103/02-220838/19 | ARGJENTA AXHAMI | 179 | 183 | 173 | 183 | | 718 |
| 01-103/02-21348/19 | ARTAN MEZRAJA | 183 | 180 | 170 | 183 | | 716 |
| 01-103/02-21254/19 | MIRLINDA HYSA | 173 | 173 | 179 | 179 | | 704 |
| 01-103/02- 21468/19 | FIKNETE KRASNIQI | 164 | 165 | 155 | 169 | | 653 |
| 01-103/02-21430/19 | EDITA SHEHU | 141 | 154 | 137 | 147 | | 579 |
| 01-103/02-20399/19 | ALBANA FUGA | 136 | 143 | 137 | 149 | | 565 |
| 01-103/02-20581/19 | ANTIGONA AXHAMI-BAFTIJAJ | 137 | 135 | 133 | 135 | | 540 |
| 01-103/02-20215/19 | GYNER GASHI | 133 | 130 | 121 | 124 | | 508 |
| 01-103/02-21334/19 | DURESA SHEHU- NIKOCI | 111 | 121 | 111 | 114 | | 457 |
| 01-103/02-21426/19 | VALBONA RAKA | 42 | 42 | 42 | 42 | | 168 |
| 01-103/02-21330/19 | GANIMETE KRASNIQI | 42 | 42 | 42 | 42 | | 168 |
| 01-103/02-21397/19 | SHUKRANE KRIVENJEVA | 36 | 36 | 36 | 36 | | 144 |
| | | | | | | | |
| | | | | | | | |
| | | | | | | | |
| | | | | | | | |
| | | | | | | | |

Nënshkrimi i kryesuesit dhe anëtarëve të komisionit

1.______ 2.______ 3.______ 4. S.Elezi 5.______

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

KAÇANIKU

Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assambly

**PËRCAKTIMI I KRITEREVE PËR TESTIMIN ME SHKRIM DHE ME GOJË PËR VENDIN E PUNËS PËR TË CILIN NUK KËRKOHET NJOHJA E NDONJË GJUHE TË HUAJ**

Titulli i vendit të punës:_ Anëtar të komitetit konsultativ për (PAK)

Numri i referencës: 01Nr.60/01-18735/19

**Të dhënat e anëtarëve të komisionit për përzgjedhjen e listës së shkurtë:**

| **Nr.** | **Emri dhe mbiemri** | **Titulli:** |
|---|---|---|
| **1.** | Murat Burrniku | Kryesues i panelit |
| **2.** | Kadri Krivenjeva | anëtar |
| **3.** | Shpend Krusha | anëtar |
| **4.** | Besnik Salihu | anëtar |
| **5.** | Sebahate Elezi | anëtare |

**Testi me shkrim:**

| **Kriteret e përzgjedhjes** | **Baza e pikëve** |
|---|---|
| Njohuritë e përgjithshme (Ese) | 50 |
| Njohuritë lidhur me vendin e punës dhe të përgjithshme | 50 |

***Numri i përgjithsëm i poenëve nga të gjitha kriteret duhet të jetë 100 pikë***

**Testi me gojë:**

| **Kriteret e përzgjedhjes** ( Pyetjet e anetareve të Komisioni) | **Baza e pikëve maksimale** |
|---|---|
| Sikurse të filloni ditën e parë të punës,cili do të ishte rekomandimi yt për Kryetarin e Komunës për (PAK) në K.Kaçanikut | 20 |
| Cilat standarde nuk janë plotësuar për (PAK) në K.Kaçanikut,dhe cilat do të ishin prioritetet e tua lidhur me këto standarde | 20 |
| Si mund të iu ndihmojm nxënsëve me (PAK) në K.Kaçanikut | 20 |
| Kompetencat e Komitetit Konsultativ | 20 |
| Parimi i mos diskriminimit | 20 |

***Numri i përgjithsëm i poenëve nga të gjitha kriteret duhet të jetë 100 pikë***

Kriteret e mësipërme mbi zgjedhjen e ngushtë përfundimtare janë miratuar nga Komisioni

Nënshkrimi i kryesuesit dhe anëtarëve të Komisionit

1.________ 2.________ 3.________ 4. S. Elezi____ 5.________

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

KAÇANIKU

Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assambly

## PËRCAKTIMI I KRITEREVE PËR PËRFSHIRJEN NË LISTËN E NGUSHTË

Titulli i vendit të punës: Anëtar të komitetit konsultativ për (PAK)

Numri i references: 01Nr.60/01-18735/19

**Të dhënat e anëtarëve të komisionit për përzgjedhjen e listës së shkurtë:**

| Nr | Emri dhe mbiemri | Titulli |
|---|---|---|
| 1. | Murat Burrniku | Kryesues i panelit |
| 2. | Kadri Krivenjeva | anëtar |
| 3. | Shpend Krusha | anëtar |
| 4. | Besnik Salihu | anëtar |
| 5. | Sebahate Elezi | anëtare |

KRITERET PËR PËRZGJEDHJE

| | |
|---|---|
| Arsimimi dhe kualifikimet profesionale<br>Diplôme Universitare | 20pikë |
| Përvoja e punës<br>E dëshirueshme | 20pikë |
| . Shkathtësit dhe aftësitë<br><br>Të jenë njohës të mirë të problematikave dhe nevojave të m(PAK)<br>Të ketë aftësi komunikuese dhe bashkepununese si dhe të jenë të përshtatshëm për punë ekipore | 20pikë |
| Elementet tjera të meritës<br>Çertifikata mbi trajnimet e kryera në fushën përkatëse | 20pikë |

***Numri i përgjithshëm nga të gjitha kriteret duhet të jetë 80 pikë***

Kriteret e mësipërme janë miratuar nga komisioni më : 15/ 07/ 2019

Nënshkrimi i Kryesuesit dhe anëtarëve të Komisionit
1.________ 2.________ 3.________ 4. S. Elezi 5.________

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

KAÇANIKU

Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assambly

**REGJISTRI I APLIKACIONEVE TË PRANUARA**

Titulli i vendit të punës: Anëtar të komitetit konsultativ për (PAK)

Numri i referencës: 01Nr.60/01-18735/19

Data e rishpalljes dhe mbylljes së konkursit: 28.06.2019 deri 12.07.2019

Data e pranimit të aplikacioneve:

| Numri i aplikacionit | Emri i kandidatit | Data e pranimit | Aplikacioni mbahet | Aplikacioni refuzohet | Të dhëna shtesë nevojiten deri më: |
|---|---|---|---|---|---|
| 01-103/02-20072/19 | MIRLINDA SPAHIJA | 03.07.2019 | | | |
| 01-103/02-2021519 | GYNER GASHI | 04.07.2019 | | | |
| 01-103/02-20399/19 | ALBANA FUGA | 05.07.2019 | | | |
| 01-103/02- 20581/19 | ANTIGONA AXHAMI-BAFIJAJ | 08.07.2019 | | | |
| 01-103/02-20838/19 | ARGJENTA AXHAMI | 09.07.2019 | | | |
| 01-103/02-21254/19 | MIRLINDA HYSA | 11.07.2019 | | | |
| 01-103/02-21430/19 | EDITA SHEHU | 12.07.2019 | | | |
| 01-103/02-21468/19 | FIKNETE KRASNIQI | 12.07.2019 | | | |
| 01-103/02-21348/19 | ARTAN MEZRAJA | 12.07.2019 | | | |
| 01-103/02-21334/19 | DURESA SHEHU - NIKOCI | 12.07.2019 | | | |
| 01-103/02-21397/19 | SHUKRAN KRIVENJEVA | 12.07.2019 | | | |
| 01-103/02-21426/19 | VALBONA RAKA | 12.07.2019 | | | |
| 01-103/02-21348/19 | GANIMETE KRASNIQI | 12.07.2019 | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova**
**Republic of Kosovo**

KAÇANIKU

**Komuna e Kaçanikut**
**Opština Kacanik**
**Municipal Kacanik**
**Kuvendi i Komunës**


01 Nr.60/01-18735/19
Kaçanik, 28.06.2019

Në mbështetje të dispozitave të Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2016 – Për procedurën e themelimit, organizimit dhe kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna dhe në bazë të Vendimit të Kuvendit të Komunës së Kaçanikut 01Nr.104/ 02- 34370/18, të datës 30.10.2018 për formimin e Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara, Kuvendi i Komunës shpall :

# KONKURS
# PËR ZGJEDHJEN E ANËTARËVE TË KOMITETIT KONSULTATIV TË KOMUNËS

1. Me këtë konkurs, bëhet zgjedhja e **7 (shtatë)** anëtarë të Komitetit Konsultativ për persona me aftësi të kufizuara në Komunën e Kaçanikut.

2. Përbërja e anëtarëve të Komitetit si në pikën 1 të konkursit duhet të reflektoj përfaqësimin gjinor.

**Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs :**

Kandidatët duhet të jenë banorë të Komunës së Kaçanikut.

**Kriteret për konkurrim :**

1. Diplomë universitare
2. Të jenë njohës të mirë të problematikave dhe nevojave të personave me aftësi të kufizuara.
3. Preferohet të kenë përvojë pune në fushën e personave me aftësi të kufizuara.
4. Të kenë aftësi komunikuese dhe bashkëpunuese si dhe të jenë të përshtatshëm për punë ekipore.

**Mandati i anëtarëve :**

Mandati i anëtarëve të Komiteteve Konsultative është 4 (katër) vjeçar, nga themelimi i Komitetit Konsultativ për persona me aftësi të kufizuara, me mundësi vazhdimi vetëm edhe për një mandat.

**Kompetenca e Komiteteve Konsultative :**

**1.** Komitetet Konsultative mund të dorëzojnë propozime nga fushë veprimtaritë e ndryshme në pajtim me Statutin e Komunës, përfshirë :

- dhënien e propozimeve për rregullore të ndryshme;
- hulumtime të ndryshme;
- japin mendime dhe ide rreth iniciativave të ndërmarra nga Kryetari i Komunës dhe Kuvendi i Komunës;
- paraqesin pikëpamjet dhe mendimet e qytetarëve te Kryetari i Komunës dhe Kuvendi i Komunës;
- japin propozime për zgjidhjen e problemeve të identifikuara.

**2.** Propozimet e cekura duhet të merren parasysh nga Kuvendi i Komunës për zhvillimin e politikave lokale.

**Kompensimi :**

- Anëtarët e komiteteve konsultative për punën e tyre kompensohen nga buxheti i komunës.
- Shuma e kompensimit duhet të jetë në proporcion me shumën e mëditjeve të anëtarëve të komiteteve të përhershme.
- Anëtarët e komiteteve nuk mund të paguhen për më shumë se 6 (gjashtë) mbledhje të cilat mbahen brenda vitit.

**Dokumentet e nevojshme për aplikim:**

Kopja e vërtetuar diplomës universitare;
Kopja e letërnjoftimit;
Ekstrakti i lindjes;
Dëshmia e përvojës së punës (e dëshirueshme) dhe
Dëshmia e trajnimeve të kryera në fushën përkatëse.

**Afati i konkursit :**

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit, prej 28.06.2019 deri më 12.07.2019.

Formularët e aplikimit merren dhe dorëzohen në Qendrën për shërbim me qytetar -Zyra e pranimit, kati përdhesë në objektin e komunës, ndërsa dokumentacioni i pa kompletuar dhe ai i cili dorzohet jashtë afatit të përcaktuar nuk do të merren parasyesh.

Për çdo informacion kandidatët mund të kontaktojnë në zyrën e Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit
Kemajl Mërseli

**SHTOJCË: Informatë rreth përzgjedhjes**

Paneli përzgjedhës me ftesën e Kryesuesit të Kuvendit z. Kemal Mërseli, ka mbajtur takimin e parë me ç 'rast ka zgjedhur kryesues z. Murat Burrniku, si dhe në të njëjtën kohë ka vendosur për formën e konkursit dhe kritereve të cilat do të duhej ti plotësojnë kandidatët potencial. Në takimin e dytë të panelit përzgjedhës, është vendosur në mënyrë unanime të shkohet në testim me shkrim si dhe ka vendosur për mënyrën e testimit me shkrim, ku testimi me shkrim të jetë në dy pjesë : pjesa e parë të jetë në formë të ese-ve dhe pjesa e dytë të jetë me pyetje lidhur me vendin e punës, ndërsa lidhur me intervistën me gojë u dakorduam që secili nga anëtarët t'ju bëhet nga një pyetje e cila ishte e njëjte për të gjithë kandidatet. Konkursi është publikuar në web-faqen e Komunës, si dhe njoftimet e kandidatëve janë bërë me mesazh telefonik si dhe me njoftim në web-faqen e Komunës dhe në tabelën e shpalljeve.

Në këtë konkurs kanë aplikuar 13 kandidat, (11 vajza dhe 2 djem). Pas verifikimit të gjitha aplikacioneve si dhe dëshmive të prezantuara nga kandidatët, paneli përzgjedhës vlerësoi se të gjithë parimisht i plotësojnë kushtet që të vazhdohet me procedurën e testimit. Kandidatet janë ftuar me kohë lidhur me testimin me shkrim dhe nga 13 kandidat të ftuar, kanë marrë pjesë vetëm 12 prej tyre në testimin me shkrim. Testimi me shkrim është mbajtur më 17.07.2019 në ora 10:00, dhe pas kontrollimit dhe verifikimit të testeve nga paneli përzgjedhës testim me shkrim e kanë kaluar vetëm 9 kandidat. Kandidatët të cilët e kanë kaluar testimin me shkrim i kemi njoftuar për testimin me gojë. Testimi me gojë është mbajtur më 19.07.2019 dhe kanë marrë pjesë 9 kandidatë, prej të cilëve 7 prej tyre e kanë kaluar testimin me gojë. Gjatë procesit të testimit gjithçka ka shkuar sipas rregullave të cilat paneli ka paraparë si dhe kandidatët ishin prezent në kohë.

Kandidatet për komitetin konsultativ për persona me aftësi të kufizuara, kanë paraqitur ide mjaft të mira në testet e tyre dhe pyetjeve të cilat u janë bërë sa i përket rolit të tyre të cilët i pret angazhimi potencial në këtë komitet, që në fakt e ka vështirësuar përzgjedhjen mes tyre. Megjithatë, paneli përzgjedhës është përkujdesur që vlerësimi të jetë sa më i drejtë dhe t'i dërgoj në kuvend emrat më meritorë dhe ka bërë vlerësimin në bazë të pikëve

Andaj, bazuar në këto që thamë më lartë, ju ftojmë që ta votoni këtë përbërje të këtij komiteti, me shpresën që kontributi i tyre të vërehet dukshëm për këtë kategori të rëndësishme të shoqërisë tone.

Kryesuesi i panelit përzgjedhës

Murat Burrniku

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Kaçanikut
Opstina Kacanik
Municipal Kacanik

*01Nr. 60/01-12570/19*
*Kaçanik, 30.04.2019*

Në bazë të nenit 12.2 (d) lidhur me nenin 73 të Ligjit Nr. 03/L-040 -Për Vetëqeverisjen e Lokale (Gazeta Zyrtare Nr. 28/04 Qershor 20108) të nenit 4, 5 dhe 8.3 e Udhëzimit Administrativ ( MAPL) Nr. 01/2016 -Për procedurën e themelimit, organizimit dhe kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna, të nenit 31, 32 lidhur me nenin 39.3 të Statutit të Komunës, të Raportit të Komisionit të Kuvendit të Komunës për shqyrtimin e Ankesave 01Nr. 60/01-12570/19, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur me datë: 30 Prill 2019, mori këtë:

**VENDIM**
**PËR RISHPALLJEN E KONKURSIT PËR ZGJEDHJEN E ANËTARËVE TË KOMITETIT KONSULTATIV PËR PERSONA ME AFTËSI TË KUFIZUARA NË KOMUNËN E KAÇANIKUT**

1. Me këtë Vendim, Anulohet Konkursi 01Nr. 111/01-3616/19 i publikuar në Faqen Zyrtare të Komunës më 07.02.2019 - Për zgjedhjen e anëtarëve të Komitetit Konsultativ për persona me aftësi të kufizuara në Komunën e Kaçanikut.

2. Të Rishpallet Konkursi Publik për zgjedhjen e anëtarëve të Komitetit Konsultativ për persona me aftësi të kufizuara në Komunën e Kaçanikut, duke përcaktuar kriteret për konkurrim.

3. Anulohet pika e 5 të Vendimit 01Nr. 104/02-34370/18 i datës 30.10.2018, për zgjedhjen e anëtarëve të Komitetit Konsultativ për persona me aftësi të kufizuara.

4. Formohet Paneli i të Përzgjedhës për zgjedhjen e anëtarëve të Komitetit Konsultativ për persona me aftësi të kufizuara në Komunën e Kaçanikut, në këtë përbërje:
   4.1. Kadri Krivenjeva anëtar nga Kuvendi,
   4.2. Shpend Krusha, anëtar nga Kuvendi,
   4.3. Besnik Salihu , anëtar nga Kuvendi,
   4.4. MURAT BURRNIKU anëtar nga Ekzekutivi; dhe
   4.5. SEBAHATE CECI anëtar nga Shoqëria Civile.

   4.1. Detyrat e Panelit përzgjedhës janë të përcaktuara në Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr.01/2016- Për Procedurën e themelimit, organizimit dhe kompetencat e komiteteve konsultative në komuna.

5. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Kryesuesi i Kuvendit dhe Kryetari i Komunës.

6. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës -MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

**Me këtë Vendim njoftohen:** MAPL, Kryetari i Komunës, anëtarët e Panelit Përzgjedhës dhe Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova
Republic of Kosovo

**Komuna e Kaçanikut**
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01Nr. 104//02-23792/19
Kaçanik, 30.07.2019

Në bazë të nenit 12 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale ( Gazeta Zyrtare Nr. 28/04 Qershor 2008) të nenit 18 pika 3. e Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 10/03 Prill 2019), duke vendosur sipas Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës, 01Nr.104/02-23792/19, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur me datën 30 Korrik 2019 , mori këtë :

**VENDIM**
**PËR NDRYSHIM PLOTËSIMIN E VENDIMIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS 01Nr. 104/02-18863/19 TË DATËS 28.06.2019- PËR FORMIMIN E KOMISIONIT TË ANKESAVE, PËR SHQYRTIMIN E ANKESAVE TË PALËVE NË PROCEDURËN E DHËNIES NË SHFRYTEZIM AFATSHKURTËR DHE AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS**

1. Me këtë vendim, Ndryshohet dhe Plotësohet Vendimi i Kuvendit të Komunës 01Nr. 104/02-18863/19 i datës 28 Qershor 2019 – Për formimin e komisionit të ankesave për shqyrtimin e ankesave të palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës.

2. Ndryshim Plotësimet e Vendimit të Kuvendit të Komunës të përcaktuar si në pikën 1 të këtij Vendimi, bëhet të paragrafi 1.4. e pikës 1 e Vendimit, ashtu që:

   2.1. Nga Komisioni me Kërkesën e tij, hiqet Mentor Shehu, anëtar i komisionit nga Ekzekutivi i Komunës.

   2.2. Në vend të anëtarit të hequr, caktohet për anëtar të komisionit nga Ekzekutivi i Komunës, Edmond Mjaku.

3. Pikët tjera të Vendimit mbesin të pandryshuara.

4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit.

5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës të MAPL, si dhe 7 pas publikimit në Faqen Zyrtare të Komunës.

**Me këtë Vendim njoftohen:** Komisioni i Ankesave, Mentor Shehu, Edmond Mjaku, Kryetari i Komunës, Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit.

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E KAÇANIKUT OPŠTINA KAČANIK REPUBLIKA KOSOVA

Kryesuesi i Kuvendit
Këmal Mërseli

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova**
**Republic of Kosovo**

**Komuna e Kaçanikut**
**Opština Kacanik**
**Municipal Kacanik**

**01Nr. 104/02-18863/19**
**Kaçanik, 28. 06.2019**

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-092 -Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës (Gazeta Zyrtare Nr. 10/ 03 Prill 2019). Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e mbajtur me 28 Qershor 2019, mori këtë:

**VENDIM**
**PËR FORMIMIN E KOMISIONIT TË ANKESAVE, PËR SHQYRTIMIN E ANKESAVE TË PALËVE NË PROCEDURËN E DHËNIES NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR DHE AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS**

1. Me këtë Vendim, formohet Komisioni i Ankesave, për shqyrtimin e ankesave të palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës, në përbërje prej 5 (Pesë) anëtarëve, si vijon:
   1.1. Vlora Dalloshi, anëtare e KK nga PDK-së
   1.2. Shpend Krusha, anëtar i KK, nga LVV,
   1.3. Zekeria Koxha, anëtar nga ekzekutivi i komunës,
   1.4. Mentor Shehu, anëtar nga ekzekutivi i komunës, dhe
   1.5. Milazim Salijaj, anëtar nga shoqëria civile (gjeometër).

2. Kryetari i Komisionit zgjidhet nga radhët e anëtarëve nga pika 1 e këtij Vendimi.

3. Detyra dhe Përgjegjësia e Komisionit të ankesave është, pranimi i ankesave të paraqitura në vlerësimin e ofertave për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë dhe shqyrtimi i tyre.

4. Administrata e komunës i ofron përkrahje komisionit të ankesave sipas kërkesave të tyre.
5. Komisioni për ankesa në Komunë bënë shqyrtimin e ankesave brenda dhjetë (10) ditëve kalendarike.
6. Palët e pakënaqura me vendimin e komisionit të ankesave, brenda afatit ligjor mund të iniciojnë kontest administrative.

7. Mandati i komisionit të ankesave është dy (2) vjeçar brenda mandatit të Kuvendit të Komunës.
8. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset, Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

9. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës- MAPL, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

**Me këtë Vendim njoftohen:** Anëtarët e komisionit, Kryetari i Komunës, Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Arkivi.

**Kryesuesi i Kuvendit**
**Kemal Mërseli**

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E KAÇANIKUT OPŠTINA KAČANIK REPUBLIKA KOSOVO